VENDIM
Nr. 156, datë 12.11.2012

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "HEC VLUSHE" SHPK, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike dhe pikës 5.3 të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.11.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Shoqëria "Aurora konstruksion" sh.p.k., ka transferuar të gjitha kuotat e saj prej 50% që posedon si ortake te shoqëria "Hec Vlushe" sh.p.k. subjektit "Anna Energia" sh.p.k., duke dhënë dorëheqjen në këtë mënyrë nga posedimi i kuotave të zotëruara te shoqëria "Hec Vlushe" sh.p.k.

- Shoqëria "Roen Company" sh.p.k., ka transferuar 1% të kuotave nga 50% që zotëron te shoqëria "Hec Vlushe" sh.p.k. shoqërisë "Anna Energia" sh.p.k.

- Në këto kushte ortakët aktualë të shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k. janë: subjekti "Anna Energia" sh.p.k., e cila posedon 51% të kuotave të kapitalit themeltar dhe subjekti "Roen Company" sh.p.k., e cila posedon 49% të kuotave të kapitalit themeltar.

- Subjekti "Anna Energia" sh.p.k., nga transaksionet e kryera rezulton si ortaku mazhoritar që kontrollon interesat e shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "Hec Vlushe" sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani